



WORLD BANK GROUP

IFC | International
Finance Corporation

Koncepti i dizajnuar për produktin e sigurimit tradicional bujqësor të specit

Projekti për financimin e sektorit të bujqësisë në Evropë dhe Azi
Qendrore

Prishtinë, Prill 2021

Në partneritet me:



Përmbledhje e përgjithshme

Ky koncept dokument mbulon parimet e përgjithshme të sigurimeve tradicionale të bujqësisë dhe është përgatitur për nevoja sigurimi, për prodhuesit, marrësit e sigurimeve, menaxherët e rreziqeve, administruesit e kërkesave, specialistët e shpërndarjes së rreziqeve, ndërmjetësit, risiguruesit, etj. Kjo do të shërbejë si bazë për përgatitjen e manualeve për marrje në sigurim, manualët e vlerësimit/trajtimin të kërkesave, çmimet dhe administrata.

Përshkrimi i kulturës

Speci është një ndër perimet më të rëndësishme në Kosovë në kuptim të sipërfaqes së mbjellur, por edhe të konsumimit të tij në forma të ndryshme nga konsumatorët. Në vitin 2015 më shumë se 3,000 hektarë janë mbjellur me spec. Kjo kulturë është e mbjellur më së shumti në rajonin e Dukagjinit, i cili gjendet në pjesën perëndimore të vendit, por në nivel vendi egzistojnë edhe disa nën rajone sa i përket kultivimit të specit: Anamorava dhe Llapi. Përveç konsumimit vendor, një pjesë e prodhimit dedikohet për eksport, kryesisht në vendet ku gjendet e koncentruar diaspora. Speci kryesisht përpunohet për prodhim të turshive dhe produkteve tjera. MBPZhR-ja siguron një subvencion prej 300€ për hektar për bujqit që e kultivojnë këtë kulturë. Numri total i fermerëve të subvencionuar në vitin 2015 ka qenë 1,138 me një fushë të përgjithshme të subvencionuar prej 1,356 hektarëve. Pragu për të drejtën për subvencionim ka qenë 0.50 hektarë të specave të kultivuar në fushat e hapura. Kjo kategori e fermerëve e ka të drejtën të aplikoj për blerjen e Polisës së Sigurimit dhe të riimburohet nga skemat e pagesave direkte. Po ashtu edhe fermerët me sipërfaqe më të vogël kanë të drejtë të blejnë polisa të sigurimit, por nuk kanë të drejtë të aplikojnë për riimbursim të premis së polisës së sigurimit nga MBPZHR.

Ekzistojnë në Kosovë tri teknologji të kultivimit të specit: teknologjia intensive, teknologjia e kombinuar, dhe teknologjia tradicionale, por që për sigurime tradicionale do të merren në konsiderim vetëm teknologjia e avancuar e kultivimit të specit.

Varietetet dhe hibridet

Polica e Sigurimit të Specit do të mbulojë humbjet për të gjitha varietetet dhe hibridet e specit që kultivohen në territorin e Republikës së Kosovës, sipas tipet në bazë të formës: Speci zile, speci banana, speci kuq Industrial dhe speci Chillit.

Teknologjia e kultivimit


Për qëllime të sigurimit tradicional, do të konsiderohen vetëm teknologjia intensive e kultivimit të specit. Karakteristikat e prodhimit të teknologjisë intensive janë: Fidanet e specit janë të mbjellura në një strukturë të dendur në një distancë mes rreshtash prej 0.6 – 0.7m dhe në një distancë të fidaneve të specit brenda rreshtit prej 0.20 – 0.25m. Në një sipërfaqe prej një hektari, një fushë e mbjellur me spec në një teknologji të tillë, varësisht edhe prej modelit të kultivimit, përmban të paktën 60,000 – 70,000 fidane speci, si parakusht për marrjen e rendimentet të lartë dhe të qëndrueshëm. Parcelat me teknologji intensive përfshijnë po ashtu edhe: sistemin e ujitjes, sistemin e plehërimit, folinë e zezë për mbulimin e tokës dhe zbatimin e masave të reja agroteknike.

Rreziqet e sigurueshme – breshëri;

Rreziqet jo të sigurueshme - që nuk do të mbulohen nga poliset e sigurimit të specit janë si më poshtë: sëmundje të cilët mund të ndikojnë negativisht në prodhimtarin e specit, siq janë: ndezja bakteriale, antraknoza, vrugu i rrënjëve, hiri specit; dëmtuesit – morrat, dhe barojat e këqija.

Periudha e mbulimit nga breshëri – 10 Korrik – 30 Shtator

Figura 1: Periudha e mbulimit për specin nga rreziku i breshërit.



Modeli i sigurimit i propozuar për sigurimin e specit - sigurimi tradicional për një rrezik (nga një rrezik).

Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dita e përfundimit të shitjeve – 5 Korrik;

Periudha e sigurimit – 10 Korrik - 30 Shtator;

Kontrata e sigurimit - një prodhues (fermer) mund të sigurojë një ose më shumë parcela në një lokacion/ rajon nën një kontratë të vetme sigurimi.

Parimi kundër zgjedhjes - Të gjitha parcelat e mbjellura që punohen nga një fermer duhet të sigurohen.

Kostot e prodhimit - Për qëllime të sigurimit tradicional, kufiri i dëmshpërblimit do të jetë kostoja totale e prodhimit për specin e kultivuar sipas teknologjisë intensive. Kufiri i koston së prodhimit për kultivuesit intensivë të specit për 1 hektarë është llogaritur në shumën prej 3,500€. Të gjitha pagesat e dëmshpërblimit për poliset e sigurimit të specit do të bazohen në këtë shumë të siguruar.

Madhësia e pranueshme e sipërfaqes së përgjithshme - nga 0.5 hektar e lartë (rekomandohet por jo plotësisht ndaluese).

Zbritshmëria – 15 – 30 % e zbatueshme për secilën humbje (shuma që zbritet nga shuma totale e siguruar).

Territori i mbulimit - të gjitha rajonet në Kosovë;

Shuma e siguruar (limiti pagesës) - bazuar në kostot e prodhimit shumëzuar me sipërfaqen e siguruar (madhësia).

Shuma e Premisë/ Çmimi – Çmimet e llogaritura për këtë polisë sigurimi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Secili çmim korrespondon me një shumë të caktuar të zbritshmërisë të paraqitur në përqindje (%).

Tabela 1: Cmimet e sigurimit bujqësor kundër breshërit për kultivuesit e specit.

<i>Shuma zbritshme (%)</i>	<i>Çmimi i Polisës së Sigurimit (euro/ ha)</i>
15%	493.50
20%	409.50
30%	252.00

Primi i Sigurimit - vlerësuar përmes shumëzimit të Shumës së Siguruar nga shkalla e premisë;

Marrësi në sigurim - Doracaku i marrjes në sigurim është përgatitur për të siguruar bazat për vlerësimin e rrezikut.

Inspektimi kulturave para vjeljes - nuk kërkohet;

Vlerësimi i humbjeve (dëmit) - Broshura për vlerësimin/ trajtimin e humbjeve do të jetë e dizajnuar dhe e disponueshme për vlerësuesit/ trajtuesit e humbjeve për t'i ndihmuar ata të kryejnë detyrat e tyre të tilla si: të kuptojnë humbjen, të përcaktojnë kohën e humbjes, vendin, të siguroarit, kulturat bujqësore, të inspektojnë dhe të përcaktojnë shkakun e humbjes, të vlerësojnë dhe të propozojnë vlerën për riimbursim, etj. Vlerësuesi/Trajtuesi i humbjes duhet të kryhet vetëm nga Vlerësuesi/Trajtuesi i humbjeve të cilët janë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Kush mund të ofrojë sigurim bujqësor - sigurimi bujqësor do të ofrohet nga kompanitë e licencuara të sigurimeve, ndërmjetësit, agjentët, bankat, institucionet mikrofinanciare (IMF), që veprojnë në Kosovë me kusht që të licencohen nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).